

VENDIM
Nr. 813, datë 16.12.2019

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË, TË PRONËS NR.914, ME EMËRTIM “AERODROM FUSHOR”, ME
VENDNDODHJE NË VLORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.
515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës nr. 914, me emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Vlorë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për infrastrukturë aeroportuale, për ndërtimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA).

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, hiqet prona nr. 914, me emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Vlorë, sipas planvendosjes, dhe shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

